

VENDIM
Nr. 49, datë 31.7.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE
MONEDHAVE EURO E TË TJERA TË HUAJA TË DYSHUARA TË FALSIFIKUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “c” dhe nenit 40 pika 1 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 11 të rregullores “Për Departamentin e Emisionit”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 16.1.2012, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe të tjera të huaja të dyshuara të falsifikuara”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë dhe subjektet e rregullores të miratuar me këtë vendim, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet udhëzimi “Për njohjen e autenticitetit të monedhave kombëtare në qarkullim e për qëndrimin ndaj monedhave që konstatohen të jenë të falsifikuara”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.3.1998.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE

**PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE E MONEDHAVE EURO DHE TË TJERA TË HUAJA TË
DYSHUARA TË FALSIFIKUARA**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objkti

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe të tjera të huaja, të dyshuara si të falsifikuara, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e tyre nga falsifikimi.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “c” dhe nenit 40 pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili

Formatted: Bullets and Numbering

këtu e më poshtë, do të quhet “ligji për bankat”;

c) ligjit nr. 9699, datë 26.3.2007 për ratifikimin e “Marrëveshjes strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European”;

d) nenit 11 të rregullores “Për Departamentin e Emisionit”, miratuar me vendimin nr. 04, datë 16.01.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e cila këtu e më poshtë, do të quhet “rregullorja e brendshme e Departamentit të Emisionit”.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë Banka e Shqipërisë, bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “kartëmonedha dhe/ose monedha të dyshuara” janë kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe/ose të tjera të huaja, me pamjen e kartëmonedhave dhe monedhave autentike, karakteristikat teknike dhe ato të elementeve të sigurisë të të cilave, gjatë procesit të kontrollit të autenticitetit, çojnë në dyshimin se mund të jenë prodhime të falsifikuara;

b) “elementet e sigurisë” janë cilësi teknike (letra e sigurisë, Watermark, mikroprintimet, shtypi i thellë, filli i sigurisë, ngjyra optike e ndryshueshme, përbërja e metaleve, dimensionet, pesha etj.) që synojnë parandalimin e prodhimit të paligjshëm të parave;

c) “ekspertizë” është procedura dhe metodat e zbatuara për të përcaktuar nëse kartëmonedhat dhe monedhat, objekte ekspertimi, përmbajnë karakteristikat teknike të prodhimit me të gjitha elementet e sigurisë së kartëmonedhave e monedhave autentike të emetuara dhe të hedhura në qarkullim nga bankat qendrore përkatëse dhe nëse këto karakteristika janë të vërteta ose jo;

d) “të dhënat teknike dhe statistikore” janë të dhënat me të cilat mund të identifikohen kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara (përshkrimi teknik i llojit të falsifikimit) dhe të dhënat mbi numrin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, sipas origjinës së tyre, veçanërisht asaj gjeografike etj.;

e) “kartëmonedha dhe monedha të falsifikuara” janë kartëmonedhat dhe monedhat me pamjen e kartëmonedhave dhe monedhave autentike, të prodhuara në mënyrë të jashtëligjshme me anë të metodave falsifikuese apo modifikimeve të ndryshme, me qëllim përdorimin e tyre të paligjshëm dhe/ose mashtrimin;

f) “pajisje të autentifikimit të kartëmonedhave” janë pajisjet për ekzaminimin e elementeve të sigurisë së kartëmonedhave, duke përfshirë zmadhuesit, llambat ultraviolet, kamerat me rreze infra të kuqe etj., të përdorura nga anëtarë të stafit gjatë përpunimit manual të kartëmonedhave për identifikimin e atyre të dyshimta;

g) “autoritete kompetente” janë autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit në Shqipëri, të tilla si: Policia e Shtetit, Prokuroria etj., si dhe autoritetet e strukturat e huaja, të ngarkuara për parandalimin dhe zbulimin e falsifikimit; këtu përfshihen pa kufizime: Banka Qendrore Europiane (ECB), Qendra e Analizës së Falsifikimit (CAC), Komisioni Europian, Zyra Kundër Mashtrimit (OLAF), Qendra Tekniko-Shkencore Europiane (ETSC), qendrat kombëtare homologe në vendet të tjera etj.;

h) “Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës” është njësi organizative në Departamentin e Emisionit të Bankës së Shqipërisë, detyrat dhe funksionet e së cilës, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje, janë të përcaktuara në nenin 11 të rregullores së brendshme të Departamentit të Emisionit;

i) “pliko” është ambalazhi i mbyllur në formën e zarfit, kutisë ose qeses, ku vendosen kartëmonedha ose monedha metalike.

KREU II

TRAJTIMI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO E TË TJERA TË HUAJA TË DYSHUARA TË FALSIFIKUARA

Neni 5

Kontrolli për autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja

1. Subjektet sigurojnë që kartëmonedhat dhe monedhat metalike euro e të tjera të huaja që marrin gjatë veprimtarisë së tyre, të kontrollohen për autenticitet me anë të makinerive të trajtimit të kartëmonedhave ose në mënyrë manuale nga një anëtar i trajnuar i personelit të tyre, me anë të pajisjeve të autentifikimit.
2. Subjektet sigurohen që të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat metalike euro e të tjera të huaja të dyshimta të zbulohen në kohë dhe të mos riqarkullohen te konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 6

Sekuestrimi i kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara

1. Subjektet sekuestrojnë menjëherë kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara, dhe i tërheqin ato nga qarkullimi.
2. Subjektet për kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara plotësojnë procesverbal sekuestrimi sipas formularit të përcaktuar në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.
3. Subjektet në momentin kur konstatojnë se kartëmonedhat dhe/ose monedhat janë të dyshuara si të falsifikuara dhe klienti është i pranishëm, i lëshojnë këtij të fundit një procesverbal sekuestrimi, duke i kërkuar të jetë në pritje të përfundimeve të rezultateve të ekspertizës.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 7

Dorëzimi vullnetar i kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara

1. Subjektet pranojnë kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara si të falsifikuara, kur dorëzohen vullnetarisht në sportelet e tyre nga persona fizikë apo juridikë.
2. Kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara, të dorëzuara në mënyre vullnetare, do t'u nënshtrohen rregullave dhe procedurave të kontrollit të autenticitetit sipas kësaj rregulloreje.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 8

Dorëzimi në Bankën e Shqipërisë

1. Kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara si të falsifikuara pas sekuestritimit dhe/ose dorëzimit vullnetar të tyre, dërgohen nga subjektet në Zyrën e Qendrës Kombëtare të Analizës pranë Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se 20 ditë pune, nga dita e konstatimit të dyshimeve.
2. Kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara si të falsifikuara dorëzohen të mbyllura në pliko, të shoqëruara me procesverbal sekuestrimi dhe kërkesë për ekspertim, sipas aneksit 2 të kësaj rregulloreje. Kërkesa për ekspertim dërgohet paraprakisht edhe në trajtë elektronike.
3. Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës, pas administrimit të plikove me kartëmonedhat dhe/ose monedhat e dyshuara, zbaton procedurën e mbledhjes, regjistrimit, ekspertizës dhe përpunimit të të dhënave teknike e statistikore të tyre.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 9

Ekspertimi i kartëmonedhave dhe/ose monedhave të dyshuara

1. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës kryen ekspertizën

Formatted: Bullets and Numbering

(analizën teknike) për përcaktimin e autenticitetit të kartëmonedhave dhe/ose monedhave euro e të tjera të huaja, të dyshuara si të falsifikuara.

2.2. Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës në përfundim të procesit të ekspertizës (analizës teknike), harton aktekspertimin ku pasqyrohen vlerësimet dhe përfundimet e analizës teknike të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara, të cilat ishin edhe objekt ekspertimi.

Neni 10

Rezultatet e ekspertimit

1. Akti i ekspertimit mbi rezultatet dhe të dhënat relevante të ekspertizës (analizës teknike) u dërgohet subjekteve, dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi mund t'u dërgohet dhe autoriteteve kompetente për zbatimin e ligjit, jo më vonë se 30 ditë pune, nga data e marrjes në dorëzim të kartëmonedhave dhe/ose monedhave.

2. Banka e Shqipërisë, në përputhje me kompetencat ligjore dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet përkatëse konfiskon pa kompensim të gjitha kartëmonedhat dhe/ose monedhat të cilat në përfundim të analizës teknike rezultojnë të falsifikuara.

3. Kartëmonedhat dhe/ose monedhat që në përfundim të analizës teknike rezultojnë autentike, i kthehen menjëherë subjektit dërgues bashkë me aktin përkatës të ekspertimit.

4. Bankat ose degët e bankave të huaja sigurojnë që vlera e kartëmonedhave ose monedhave të rezultuara autentike t'i kalohet menjëherë personit që i ka dorëzuar ose që i janë sekuestruar si të dyshuara.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 11

Mbajtja dhe ruajtja e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara

1. Kartëmonedhat dhe/ose monedhat që në përfundim të analizës teknike rezultojnë të falsifikuara do të mbahen në ruajtje për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare) në Bankën e Shqipërisë. Në përfundim të afatit të ruajtjes kartëmonedhat dhe/ose monedhat mund të asgjësohen sipas rregullave procedurale të vendosura në Bankën e Shqipërisë.

2. Mostrat e përzgjedhura nga kartëmonedhat dhe/ose monedhat e falsifikuara si pjesë përbërëse e albumeve apo katalogëve do të mbahen pa afat, duke qenë pjesë e inventarit të kartotekës së Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës.

3. Qendra Kombëtare e Analizës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, do të dorëzojë kartëmonedhat dhe/ose monedhat në ruajtje kur janë objekt shqyrtimi në çështje penale, në baze të kërkesës me shkrim nga autoritetet kompetente përkatëse.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 12

Përdorimi i kartëmonedhave dhe/ose monedhave të falsifikuara

1. Qendra Kombëtare e Analizës përdor kartëmonedhat dhe/ose monedhat e falsifikuara si materiale për:

a) organizimin e seminareve për parandalimin e falsifikimit; dhe

b) programimin dhe testimin e makinerive dhe pajisjeve të autentifikimit të kartëmonedhave dhe/ose monedhave.

2. Banka e Shqipërisë, me qëllim programimin dhe testimin e makinerive ose pajisjeve të autentifikimit nga subjektet bankare apo sipërmarrësit e angazhuar në këtë proces, me kërkesën me shkrim të tyre mund të japë për përdorim të përkohshëm mostra kartëmonedhash dhe monedhash të falsifikuara.

Formatted: Bullets and Numbering

Neni 13

Bashkëpunimi me autoritetet kompetente

1. Banka e Shqipërisë, ka të drejtë të lidhë marrëveshje me Bankën Qendrore Europiane dhe autoritete të tjera analoge, në fushën e mbrojtjes së monedhës euro dhe monedhave të tjera të huaja nga falsifikimi. Banka e Shqipërisë siguron zbatimin e harmonizuar të këtyre marrëveshjeve me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Formatted: Bullets and Numbering

2. Banka e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente vendase e të huaja për shkëmbim informacioni, lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen e kartëmonedhave e monedhave euro e të tjera të huaja nga falsifikimi.

3. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet kompetente përkatëse, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, në veçanti për:

a) shkëmbimin, për kryerjen e analizave strategjike, të informacionit të rregullt mbi falsifikimin;

Formatted: Bullets and Numbering

b) sigurimin e ndihmës së ndërsjellë në parandalimin dhe luftimin e falsifikimit që përfshin ndër të tjera, mbështetjen shkencore dhe trajnimet mbi logjistikën.

c) lidhjen e memorandumeve ose marrëveshjeve përkatëse ndër-institucionale, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

4. Banka e Shqipërisë në përputhje me kompetencat ligjore dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet përkatëse me qëllim verifikimin e rezultateve të autentifikimit, kur është e përshtatshme, mund të dërgojë kartëmonedha dhe monedha euro e të tjera të huaja, të dyshuara si të falsifikuara te autoritetet kompetente të huaja.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Zbatimi i kërkesave rregullative

1. Departamenti i Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë, realizon verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga subjektet, veçanërisht nëpërmjet:

Formatted: Bullets and Numbering

a) kryerjes së inspektimeve në vend, në vendndodhjet e subjekteve, për të monitoruar aftësinë e tyre për të verifikuar autenticitetin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave të dyshuara; dhe

b) verifikimit të procedurave që rregullojnë trajtimin e kartëmonedhave të kontrolluara dhe procedurat që rregullojnë çdo kontroll manual të autenticitetit.

Formatted: Bullets and Numbering

2. Subjektet, janë të detyruara të marrin masat e nevojshme organizative dhe teknike për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja e saj në fuqi.

3. Nëse Banka e Shqipërisë konstaton moszbatim të dispozitave të kësaj rregulloreje do të kërkojë marrjen e masave korrigjuese nga ana e subjekteve brenda një afati kohor të specifikuar.

Neni 15

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore.

Neni 16

Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

PROCESVERBAL
(Sekuestrimi i kartëmonedhave/monedhave të dyshuara si të falsifikuara)

Procesverbal mbahet për kartëmonedhat/monedhat e dyshuara si të falsifikuara dhe të sekuestrohuara nga policia në tërësi ose pjesërisht. Në procesverbal shënohet emri dhe mbiemri, numri dhe identifikimi apo të pasaportës, shtetësia, adresa dhe telefoni i personave të dyshuar.

[illegible]

MONEDHAT			
Lloji i parasë	Prerja	Viti i emetimit	Nr. në copë

Paratë (lloji i monedhës) e sekuestruara do të dorëzohen në Bankën e Shqipërisë për ekspertizë, verifikimin e autenticitetit (vërtetësisë). Ne do t'u informojmë për konkluzionet e ekspertizës pasi të aktin e ekspertimit.

lidhur me
marrim

Vendi dhe data: _____
(për paratë e sekuestruara)

Dorëzuesi: _____
(emër mbiemër e nënshkrim)

Vula

Personi lëshues i procesverbalit: _____
(emri, mbiemri e nënshkrimi)

Aneksi 2

Nr. prot.: _____
Vendi dhe data: _____

KËRKESË PËR EKSPERTIM
PËR TË PËRCAKTUAR AUTENTICITETIN E KARTMONEDHAVE/MONEDHAVE

KARTËMONEDHAT			
Lloji parasë	Prerja	Numri serial	Nr. në copë

MONEDHAT			
Prerjet	Numri serial	Viti i emetimit	Nr. në copë

Shënim. Ky formular do të plotësohet duke filluar nga kartëmonedha me prerje më të madhe dhe kjo e renditur sipas vitit të emetimit më të hershëm. Po kështu do të veprohet edhe me monedhat.

Data dhe vendi i konstatimit të parave të dyshuara si të falsifikuara: Rrethanat shkurt të konstatimit	Data:	
	Vendi:	
	Konstatimi në sportel	☐
	Konstatimi gjatë procesit të përpunimit	☐
	Konstatimi në bankë; origjinë e panjohur	☐
	Konstatimi në rrethana të tjera	☐

Informacion mbi personin që i janë sekuestruar para të dyshuar të falsifikuara, ose që kërkon vërtetimin e tyre:	Emër dhe mbiemër:	
	Adresa:	
	Telefon:	
	Numri i kartës së identitetit ose i pasaportës	

Vendi i vulës

(nënshkrimi i personit të autorizuar)

